



Procedurat standarde të veprimit në rast të pandemisë

Rekomandime për masat që duhen marrë parasysh
gjatë situatave të pandemisë në të ardhmen



Përmbajtja

Historiat.....	3
Procedurat standarde operationale (PSO)	5
1. Të përgjithshme.....	5
2. Pajisjet mbrojtëse.....	6
3. Zyrat dhe ambientet e tjera.....	7
4. Masat brenda policisë - Takimet	7
5. Masat brenda policisë - Edukimi dhe trajnimi	8
6. Masat brenda policisë - Puna nga shtëpia	8
7. Masat brenda policisë - Rezerva strategjike	8
8. Masat brenda policisë - Monitorimi i situatës	9
9. Procedurat në rastin e zbulimit të infeksionit.....	10
10. Masa e mundshme operationale (masa të tjera që zakonisht nuk përfshihen në punën e policisë)	10
11. Krijimi i një qendre operationale 24/7	11
12. Bashkëpunimi ndërkombëtar	11
13. Intervistat, marrjet në pyetje, ankesat... ..	12
14. Procedurat e rregullta (patrollimet, trafiku, rendi publik...).....	12
15. Përdorimi i automjeteve.....	13
16. Masat shitesë në kufirin jeshil/blu - të huajt.....	13
17. Masat shitesë në pikat e kalimit kufitar (PKK).....	14
18. Informimi i publikut.....	14
19. Qendra e telefonatave në polici	15
Mohim i përgjegjësisë	15

Historiat

Gjatë shpërthimit të COVID-19 dhe përhapjes së tij në mbarë botën dhe nëpër Evropë, vendet kanë përqendruar vëmendjen dhe përpjekjet e tyre në kufizimin e përhapjes së mëtejshme të tij tek popullsia e tyre. Vendet ndërmorën një sërë praktikash dhe masash me shpresën për të zgjidhur çështjen sa më shpejt të jetë e mundur. Këto veprime dhe praktika përfshinin masa të tilla, si: shtetrrëthim policor, kufizim në lëvizje, ndalim në kalimet kufitare, etj.

Për të qenë në gjendje të sigurojnë vazhdimësinë e operacioneve dhe ofrimin e shërbimeve të tyre të rregullta (p.sh. hetime penale, mbikëqyrje të kufirit, etj.), shërbimet e zbatimit të ligjit (ZL), si pjesë e “organizatave të reagimit të shpejtë” duhet të përshtaten me mjedisin e ri në kohë reale, duke u përballur kështu me sfida të reja dhe me presion shtesë.

Sfidat kryesore të organizatave policore gjatë kësaj kohe ishin sigurimi i mirëqenies së oficerëve të cilët punojnë në terren, ofrimi i shërbimeve të tyre me sa më pak ndërprerje të jetë e mundur dhe ruajtja e respektit më të madh të mundshëm të të drejtave të njeriut në këtë gjendje të jashtëzakonshme gjatë zbatimit të vendimeve urgjente parlamentare ose qeveritare me qëllim vendosjen e kontrollit mbi përhapjen e COVID-19.

Për të mbështetur përpjekjet për të zvogëluar ndikimin negativ të incidenteve të mundshme nga fatkeqësitë natyrore dhe/ose nga fatkeqësitë e shkaktuara nga vetë njeriu në vazhdimësinë e shërbimeve të zbatimit të ligjit, si në nivel strategjik, ashtu edhe në atë operacional, DCAF Ljubljana (si pjesë e Programit të Sigurisë Kufitare - më tej PSK) ka përgatitur Procedurat Standarde Operacionale (PSO) për t’iu përgjigjur situatave të pandemisë.

Qëllimi i Procedurave Standarde Operacionale (PSO) është të formulojnë një **seri hapash dhe rekomandimesh, të cilat do të merren parasysh në nivel strategjik dhe operacional, për t’iu përgjigjur më së miri situatave të jashtëzakonshme akute**, të cilat mund të paraqiten vetë.

Procedurat Standarde Operacionale janë duke u zhvilluar përmes kombinimit të një qasjeje nga lart-poshtë dhe nga poshtë-lart, në bashkëpunim dhe koordinim me përfaqësuesit ekspertë të shërbimeve përkatëse të përfituesve të Programit të Sigurisë Kufitare, veçanërisht ata që punojnë në fushën e planifikimit të përgjigjes, planifikimit operacional dhe analizës së rrezikut.

Rekomandimet e renditura në faqet në vijim, mbi masat që duhen marrë kur përballeni me një situatë të tipit pandemik, u nxorën nga përgjigjet e marra nga përfaqësuesit e shërbimeve përkatëse të zbatimit të ligjit të përfituesve të Programit të Sigurisë Kufitare.

Si të tilla, ato nuk përfaqësojnë një listë gjithëpërfshirëse të masave që duhen zbatuar dhe duhet të përditësohen dhe të kontekstualizohen për të pasqyruar situatën specifike në secilin prej përfituesve.

Lista nuk paraqet domosdoshmërisht strukturën përfundimtare dhe ndarjen e rekomandimeve dhe si e tillë do të rregullohet bazuar në reagimet e marra nga përfaqësuesit e shërbimit të zbatimit të ligjit të përfituesve të Programit të Sigurisë Kufitare.

Rekomandimet janë të grupuara sipas kategorive të mëposhtme:

1. Të përgjithshme
2. Pajisjet mbrojtëse
3. Zyrat dhe ambientet e tjera
4. Masat brenda policisë - Takimet
5. Masat brenda policisë - Edukimi dhe trajnimi
6. Masat brenda policisë - Puna nga shtëpia
7. Masat brenda policisë - Rezerva strategjike
8. Masat brenda policisë - Monitorimi i situatës
9. Procedurat në rastin e zbulimit të infeksionit
10. Masa e mundshme operationale (masa të tjera që zakonisht nuk përfshihen në punën e policisë)
11. Krijimi i një qendre operationale 24/7
12. Bashkëpunimi ndërkombëtar
13. Intervistat, marrjet në pyetje, ankesat...
14. Procedurat e rregullta (patrullimet, trafiku, rendi publik...)
15. Përdorimi i automjeteve
16. Masat shitesë në kufirin jeshil/blu - të huajt
17. Masat shitesë në pikat e kalimit kufitar (PKK)
18. Informimi i publikut
19. Qendra e telefonatave në polici

Procedurat standarde operacionale (PSO)

1. Të përgjithshme

- Përgatitni një plan veprimi në qasjen ndaj situatave të pandemisë.
- Përgatitni udhëzime për performancën e sigurt të punës për të gjithë punonjësit.
 - Udhëzimet duhet të përmbajnë veprimet e pritshme të punonjësve në zbatimin e masave parandaluese për përhapjen e infeksionit. Udhëzimet duhet të përfshijnë fushat e mëposhtme: përdorimi dhe mbajtja e pajisjeve mbrojtëse, masat e sigurisë në të gjitha ambientet, procedurat dhe detyrat e punonjësve në rast të zbulimit të shenjave të infeksionit ose njoftimi për kontaktin me një person të infektuar, rregullimi i aktiviteteve të punës dhe ekzekutimi i kompetencave.
- Shpërndani udhëzimet në të gjitha njësitë organizative.
- Sigurohuni që të gjithë punonjësit të njihen me udhëzimet e përgatitura.
 - Krijoni një sistem, i cili siguron që të gjithë punonjësit në organizatë të jenë të përditësuar me udhëzimet, pavarësisht nga pozicioni që ata mbajnë.
- Përditësoni udhëzimet në bazë të zhvillimit të situatës.
 - Përditësoni udhëzimet për të pasqyruar ndryshimet në situatën e sigurisë duke marrë parasysh rekomandimet dhe zhvillimet më të fundit.
- Sigurohuni që të gjithë punonjësit të njihen me ndryshimet e udhëzimeve (me udhëzimet e përditësuara).
- Përgatitni udhëzime të veçanta për drejtuesit.
 - Përveç udhëzimeve për të gjithë punonjësit mbi veprimet e pritshme në zbatimin e masave parandaluese për përhapjen e infeksionit, duhet të përgatiten edhe udhëzimet për stafin drejtues dhe menaxhues në të gjitha nivelet organizative. Këto udhëzime përfshijnë aspekte të ndryshme organizative që duhet të merren parasysh dhe të sigurohen nga stafi drejtues dhe menaxhues.
- Krijoni një sistem informues për punonjësit lidhur me masat e marra në të gjitha nivelet e policisë.
- Promovoni vaksinimin në mesin e punonjësve.
 - Në varësi të disponueshmërisë së vaksinës, vaksinimi duhet të promovohet mes punonjësve dhe (nëse është e mundur) të organizohet nga shërbimi. Në varësi të situatës epidemiologjike, duhet të organizohet testimi periodik (javor) i punonjësve të pavaksinuar.

2. Pajisjet mbrojtëse

- Blini një numër të mjaftueshëm të pajisjeve mbrojtëse (maska, doreza, dezinfektues e të tjera).

Lloji i pajisjeve mbrojtëse të përshtatshme duhet të identifikohet nga një grup profesionistësh, bazuar në karakteristikat e njohura të përhapjes së infeksionit viral.

Blerja duhet të bëhet në nivel qendror.

- Shpërndani pajisjet mbrojtëse në të gjitha njësitë. Sigurohuni që të gjithë punonjësit të kenë një numër të mjaftueshëm të artikujve të pajisjeve mbrojtëse.

“Numri i mjaftueshëm i artikujve” mund të llogaritet bazuar në konsumin mesatar ditor për njësi. Rekomandohet që secila njësi të ketë numër të mjaftueshëm artikujsh për 30 ditët e ardhshme.

- Mbani rezerva të mjaftueshme të pajisjeve mbrojtëse që të jenë të disponueshme (në nivel kombëtar).

“Numri i mjaftueshëm” në nivel kombëtar varet nga konsumi mesatar ditor. Rekomandohet që të ketë rezerva të mjaftueshme të artikujve të paktën për 90 ditë. Ky numër duhet të rritet kur keni probleme në shpërndarje ose kur priten probleme të tilla.

- Ndiqni konsumimin e pajisjeve mbrojtëse.
- Njihni të gjithë punonjësit me udhëzimet për përdorimin e duhur të pajisjeve mbrojtëse, si dhe për asgjësimin e duhur të artikujve të përdorur.
- Pajisni çdo automjet me një numër të mjaftueshëm të pajisjeve mbrojtëse (maska, doreza, dezinfektues...)

Çdo automjet duhet të ketë një numër të mjaftueshëm artikujsh në dispozicion. Rekomandohet që numri i artikujve në secilin automjet të jetë të paktën sa dyfishi i konsumit mesatar ditor të njësisë së patrullimit.

- Njihni të gjithë punonjësit me udhëzimet për higjienën e duhur, për rëndësinë e largjes së duhur dhe të rregullt të duarve, dezinfektimin e duarve...
- Informoni të gjithë punonjësit për rëndësinë e pastërtisë dhe higjienës në lidhje me uniformën dhe veshjet e tjera.

3. Zyrrat dhe ambientet e tjera

- Kryeni kontrolle në të gjitha hyrjet e ambienteve tona.
- Regjistroni çdo person që hyn në ambientet tona.
 - ▮ Mbatja e një regjistri të të gjithë personave që hyjnë në ambiente lejon rindërtimin epidemiologjik të kontakteve në rast infektimi.
- Matni temperaturën e çdo personi që hyn në ambiente, pa përjashtim.
 - ▮ Në varësi të karakteristikave të infeksionit, kontrolloni me kujdes simptomat për personat që hyjnë në ambientet tuaja. Për matjen e temperaturës së trupit, rekomandohet të përdoren termometra pa prekje ose sisteme të tjera elektronike.

4. Masat brenda policisë - Takimet

- Kaloni takimet në një mjedis online sa më shumë që të jetë e mundur.
- Organizoni vetëm ato takime sy më sy që janë të nevojshme dhe nuk mund të shtyhen ose organizohen në ndonjë mënyrë tjetër (p.sh. online).
- Kufizoni kohëzgjatjen e takimeve sy më sy në minimum.
- Organizoni takimet sy më sy në një mënyrë që lejon distancën minimale të sigurisë mes pjesëmarrësve.
- Organizoni takimet sy më sy në zyra më të mëdha (hapësira më të mëdha).
- Udhëzoni punonjësit që të mbajnë pajisjet e nevojshme mbrojtëse gjatë takimit sy më sy.

5. Masat brenda policisë - Edukimi dhe trajnimi

- Shmangni kryerjen e trajnimeve sy më sy. Organizoni vetëm ato trajnime sy më sy që nuk mund të shtyhen.
- Organizoni një trajnim mbi pandeminë (p.sh. webinar ose orë online për të gjithë punonjësit).

Shmangni kryerjen e trajnimeve sy më sy. Organizoni vetëm ato trajnime sy më sy që nuk mund të shtyhen. Organizoni një trajnim mbi pandeminë (p.sh. webinar ose orë online për të gjithë punonjësit).

6. Masat brenda policisë - Puna nga shtëpia


- Përgatitni aktet e nevojshme ligjore që punonjësit të punojnë nga shtëpia.
- Përcaktoni kushtet për të punuar nga shtëpia.
- U siguron punonjësve pajisjet e duhura teknike për të punuar nga shtëpia (p.sh. laptopë).
- Siguroni mjetet e nevojshme të IT-së për komunikim të sigurt dhe punë nga shtëpia (p.sh. lidhja VPN).

7. Masat brenda policisë - Rezerva strategjike

- Krijimi i rezervave strategjike përmes sistemit të rezervave të policisë (polici ndihmëse).
- Largoni një numër të caktuar oficerësh përkohësisht nga puna në njësi të ndryshme.

Largimi i një pjese të forcës policore nga puna (mungon në punë), lejon formimin e “rezervave” të oficerëve në rast se numri i të infektuarve midis tyre rritet. Me këtë masë mund të ruhet vazhdimësia e punës.

- Ndryshoni kohëzgjatjen e turneve për të zvogëluar numrin e kontakteve mes punonjësve.

- 
- Organizoni punën e punonjësve në grupe për të zvogëluar kontaktet mes tyre.

Me formimin e grupeve të punës dhe/ose ekipeve të punës (të ashtuquajtura flluska) numri i kontakteve mes punonjësve të ndryshëm zvogëlohet, duke zvogëluar kështu mundësinë e përhapjes së infeksionit. Grupet duhet të jenë sa më të vogla, duke ruajtur aftësitë operacionale. Kontakti mes grupeve të ndryshme duhet të reduktohet në minimum.

8. Masat brenda policisë - Monitorimi i situatës

- Krijoni një grup të posaçëm pune për monitorimin e situatës dhe hartimin e rekomandimeve.
- Monitoroni sigurinë dhe situatën epidemiologjike në vendin tonë çdo ditë.
- Monitoroni sigurinë dhe situatën epidemiologjike në vendet e tjera çdo ditë.
- Kufizoni udhëtimet e punës në vendet e tjera për punonjësit tuaj.
- Monitoroni situatën në lidhje me aktivitetet/kapacitetet operacionale dhe zhvillimet në vend çdo ditë.
- Monitoroni gjendjen e punonjësve tanë (të infektuar, në punë, në karantinë...) çdo ditë.
- Rregulloni përparësitë e punës.
- Rregulloni udhëzimet për performancën e sigurt të punës sipas situatës aktuale epidemiologjike.

9. Procedurat në rastin e zbulimit të infeksionit

- Në rast infektimi, udhëzoni punonjësit të izoloohen.
- Në rast të kontaktit të punonjësve me një person të infektuar, menjëherë bëni një hartë të kontakteve të atij punonjësi, si dhe për punonjësit shtesë, me të cilët punonjësi i parë ka qenë në kontakt.
- Udhëzoni të gjithë punonjësit të informojnë eprorin e tyre nëse fillojnë të shfaqin shenja të infeksionit.
- Siguroni testime për punonjësit që kanë qenë në kontakt me një person të infektuar, pavarësisht nëse ata shfaqin apo jo ndonjë simptomë.
- Udhëzoni punonjësit që shfaqin shenja infeksioni të qëndrojnë në karantinë derisa të merren rezultatet e testimit.
- Në rast të infektimit të punonjësit, dezinfektoni të gjitha sipërfaqet me të cilat ai/ajo ka rënë në kontakt.
- Komunikoni rregullisht me punonjësit e infektuar në lidhje me mirëqenien e tyre.

10. Masa e mundshme operationale (masa të tjera që zakonisht nuk përfshihen në punën e policisë)

- Jini aktiv në përgjigjen ndaj pandemisë dhe në planifikimin e masave që synojnë të kufizojnë përhapjen e saj.

Agjencitë e zbatimit të ligjit pritet të ndërmarrin detyra shtesë në punën e tyre, në përgjigje të dekreteve dhe masave të marra për të kufizuar përhapjen e infeksionit. Këshillohet roli aktiv dhe planifikimi parandalues i masave dhe burimeve.

Masat shtesë mund të përfshijnë:

- Masa shtesë në kufirin shtetëror (mbyllje, kufizim të kalimeve...);
- Detyra të ndryshme shtesë brenda (p.sh. kontrolle në lidhje me respektimin e vendimeve për karantinë, kufizime në lëvizje, respektim të orëve policore...);
- Mbështetje për organet e tjera (punonjësit e shëndetit, informimi nga qeveria ose organe të tjera përkatëse, ngritje të grupeve humanitare...)

11. Krijimi i një qendre operationale 24/7

- Krijoni një qendër për koordinimin e aktiviteteve që lidhen me pandeminë brenda policisë (emërtimi i qendrës mund të ndryshojë nga vendi në vend).

Rekomandohet që të krijohet një qendër e veçantë, e përkushtuar dhe koordinuese, e cila përqendrohet në masat për të kufizuar përhapjen e infeksionit. Detyrat e qendrës duhet të përfshijnë (por të mos kufizohen në):

- Koordinimin e punës mes policisë dhe organeve të tjera (përfshirë ministrinë);
- Koordinimin e aktiviteteve me vendet fqinje;
- Sqarimin e pyetjeve në lidhje me pandeminë;
- Mbledhjen dhe dhënien e informacionit (për aktivitetet dhe masat e ndryshme, p.sh. në pikat e kalimit kufitar).

12. Bashkëpunimi ndërkombëtar

- Vendosni kontakte të rregullta me vendet fqinje në të gjitha nivelet (p.sh. kombëtare, rajonale, lokale).

Rekomandohet që të vendosen kontakte të rregullta për të siguruar shkëmbimin në kohë të informacionit mbi zhvillimet dhe për një koordinim më të mirë të aktiviteteve me interes reciprok. Diskutimet duhet të përfshijnë (por jo të kufizohen në):

- Diskutimin dhe koordinimin e masave në kufi (pikat e kalimit kufitar (PKK), kufiri jeshil/blu);
- Shkëmbimin e përvojës dhe praktikës;
- Krijimin e korridoreve të ndryshme;
- Masat që lidhen me menaxhimin e migrimit.

13. Intervistat, marrjet në pyetje, ankesat...

- Sa herë që është e mundur, bëni intervista me telefon.
- Vendosni xham mbrojtës mes oficerit të policisë dhe klientit (ky term përfshin kategori të ndryshme të personave në procedurat policore) në hapësirat ku zhvillohen intervistat.
- Udhëzoni çdo klient të deklarojë nëse ai/ajo ka ndonjë simptomë të lidhur me pandeminë para se të hyjë në ambiente.
- Udhëzoni klientët që të dezinfektojnë duart para se të hyjnë në ambientet e policisë.
- Vendosni shenja në të gjitha shënimet që klientët të shohin kërkesat dhe masat e vendosura.
- Lejoni oficerin në hyrje të kontrollojë nëse klientët janë në pajtueshmëri me kërkesat dhe masat e vendosura.
- Udhëzoni klientët që të mbajnë maskë mbrojtëse kur janë në ambientet e policisë (ose pajisje të tjera mbrojtëse siç konsiderohen të nevojshme për të kufizuar përhapjen e pandemisë).

14. Procedurat e rregullta (patrullimet, trafiku, rendi publik...)

- Udhëzoni të gjithë punonjësit e policisë që të mbajnë maska mbrojtëse si brenda (në ambiente të mbyllura) ashtu edhe jashtë.
- Udhëzoni të gjithë punonjësit e policisë që të mbajnë distancën minimale të sigurisë gjatë punës së tyre.
- Udhëzoni të gjithë punonjësit e policisë që të kryejnë procedura të ndryshme në hapësira të hapura sa më shumë që të jetë e mundur (p.sh. marrja e deklaratave duhet të bëhet jashtë nëse është e mundur...).
- Shmangni kryerjen e procedurave me klientët në automjetet e policisë (vetëm punonjësit e policisë duhet të lejohen të hyjnë në automjetin e policisë).

- Udhëzoni punonjësit e policisë që të përdorin gjithmonë pajisje mbrojtëse (maska, doreza...) në të gjitha procedurat me personat, edhe kur prekin sende të ndryshme është e nevojshme (p.sh. kontrollimi i bagazheve ose automjeteve).
- Udhëzoni punonjësit e policisë që të dezinfektojnë duart pas çdo procedure.
- Udhëzoni që të gjithë punonjësit e policisë të shmangin çdo prekje të panevojshme të sendeve gjatë procedurave.

15. Përdorimi i automjeteve

- Formoni ekipe të përhershme (ose afatgjata) të njësive të patrullimit.
 Rekomandohet të formohen grupe për një periudhë më të gjatë kohore në mënyrë që të zvogëlohet kontakti midis oficerëve të ndryshëm, duke zvogëluar kështu mundësinë e përhapjes së infeksionit.
- Zbatoni rregullin “një polic për automjet”.
 Rregulli “një oficer për automjet” do të thotë që gjatë patrullimit vetëm një polic mund të jetë në një automjet policie. Falë kësaj mase, zvogëlohet numri i kontakteve mes oficerëve dhe intensiteti i kontakteve të tyre.
- Dezinfektoni rregullisht automjetet.
- Ajrosni rregullisht automjetet.

16. Masat shpresë në kufirin jeshil/blu - të huajt

- Gjatë procedurave me të huajt, kontrolloni nëse ka simptoma të infeksionit.
- Ajrosni rregullisht ambientet ku mbahen të huajt.
- Dezinfektoni rregullisht ambientet ku mbahen të huajt.
- Ajrosni rregullisht automjetet që përdoren për transportin e të huajve.
- Dezinfektoni rregullisht automjetet që përdoren për transportin e të huajve.

17. Masat shpresë në pikat e kalimit kufitar (PKK)

- Udhëzoni punonjësit e policisë që të kryejnë kontrolle kufitare (kontrolle të dokumenteve) kryesisht nga brenda kabinës së kontrollit të pasaportave.
- Udhëzoni punonjësit e policisë që të mbajnë doreza mbrojtëse gjatë kontrolleve kufitare.
- Udhëzoni punonjësit e policisë që të mbajnë maska mbrojtëse gjatë kontrolleve kufitare.
- Udhëzoni punonjësit e policisë që të shmangin çdo prekje të panevojshme të sendeve gjatë procedurës.
- Udhëzoni udhëtarët të dalin nga automjetet e tyre gjatë kontrolleve të detajuara kufitare.
- Udhëzoni punonjësit e policisë që të dezinfektojnë duart pas çdo kontrolli të detajuar kufitar.

18. Informimi i publikut

- Krijoni një seksion të veçantë në faqen tonë të policisë në internet duke siguruar informacion në lidhje me pandeminë.
- Krijoni një seksion të veçantë në faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme (emërtimi mund të ndryshojë nga vendi) duke siguruar informacion në lidhje me përhapjen dhe kufizimin e pandemisë.
- Informoni publikun për masat që lidhen me përhapjen dhe kufizimin e pandemisë përmes deklaratave, përgjigjeve dhe sqarimeve për mediat.
- Informoni udhëtarët mbi masat që lidhen me kufizimin e pandemisë në pikat e kalimit kufitar.

19. Qendra e telefonatave në polici

- Krijoni një qendër telefonatash për informimin e publikut në lidhje me masat e kufizimit të pandemisë.
- Krijoni një numër telefoni të vetëm (të unifikuar) për të kontaktuar qendrën e telefonatave për informim.
- Krijoni një llogari të postës elektronike për qendrën e telefonatave për informim.
- Pajisni të gjithë punonjësit të cilët punojnë në qendrën e telefonatave me informacion mbi masat aktuale, udhëzimet dhe informacione të tjera.
- Angazhoni ata punonjës në qendrat e telefonatave që dinë gjuhë të huaja.

Mohim I përgjegjësisë

Dokumenti Procedurat Standarde Operacionale nuk paraqet një listë gjithëpërfshirëse të masave që duhen zbatuar ose konsideruar në përgjigje të situatave pandemike. Dokumenti synon të sigurojë një përmbledhje të masave që janë marrë parasysh dhe zbatuar në përgjigje të shpërthimit të pandemisë COVID-19. Si i tillë, ai shërben si një listë rekomandimesh për masat që duhen marrë parasysh kur t'u përgjigjeni situatave të mundshme pandemike në të ardhmen, për të siguruar vazhdimësinë e shërbimeve të zbatimit të ligjit, si dhe për të marrë parasysh sigurinë e oficerëve.



DCAF Geneva Centre
for Security Sector
Governance



Zhvilluar nga DCAF në kuadër të projektit "Bashkëpunimi
policor rajonal dhe ndërtimi i integritetit në Ballkanin
Perëndimor".

Zhvillimi i Procedurave Standarde Operacionale (PSO) u bë
i mundur përmes financimit brenda projektit të dhënë nga
Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë.